



Integriteti i listave zgjedhore

(Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 7 qershor 2026)



Prishtinë, Maj 2026

Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Implementuar nga:



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Maj, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	6
Hyrje.....	7
1. Përmbledhje ekzekutive.....	8
2. Zgjedhjet e parakohshme 2026	9
3. Dekriminalizimi i politikës.....	10
4. Pastërtia e listave për Zgjedhjet e Parakohshme 2026.....	11
5. Kandidatët me aktakuza aktive	11
6. Kandidatët me dënime penale.....	13
7. Kandidatët e përfshirë në raste penale sipas subjekteve	15
8. Kandidatët e përfshirë në raste penale sipas veprave	16
9. Krahasimi me zgjedhjet paraprake.....	18

Lista e Shkurtesave

IKD	–	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KQZ	–	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LVV	–	Lëvizja Vetëvendosje
PDK	–	Partia Demokratike e Kosovës
AAK	–	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
PSD	–	Partia Socialdemokrate
KDTP	–	Partia Demokratike Turke e Kosovës
SDU	–	Unioni Socialdemokrat
IRDK	–	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
LS	–	Lista Serbe

Hyrje

IKD vazhdimisht avokon për dekriminalizimin e politikës dhe forcimin e integritetit të personave që synojnë të ushtrijnë funksione publike. Në këtë drejtim, IKD vlerëson se personat të cilët janë të përfshirë në raste penale, edhe në rastet kur nuk ekzistojnë kufizime të drejtpërdrejta ligjore, me qëllim të forcimit të integritetit dhe ruajtjes së parimeve të qeverisjes së mirë, nuk duhet të jenë pjesë e listave zgjedhore dhe as bartës të funksioneve publike.

Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton se e drejta për kandidim u kufizohet vetëm personave të cilët në tri (3) vitet e fundit janë dënuar me vendim të formës së prerë me një (1) vit ose më shumë burgim efektiv. Megjithatë, IKD konsideron se subjektet politike duhet të aplikojnë standarde më të larta të integritetit edhe përtej kufizimeve minimale ligjore. Për këtë arsye, IKD vazhdimisht ka kërkuar nga subjektet politike që në listat zgjedhore të mos përfshijnë persona të cilët kanë probleme me ligjin në kuptim të aktakuzave aktive dhe/apo dënimeve penale. Qëndrimi për moskandidimin e personave të përfshirë në raste penale nuk nënkupton paragjykim të fajësisë së tyre dhe as cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Përkundrazi, një qasje e tillë synon të kontribuojë në rritjen e standardeve të integritetit publik dhe besimit qytetar në institucionet përfaqësuese.

Sikurse edhe në proceset zgjedhore paraprake, IKD duke u bazuar në të dhënat e monitorimit, ka analizuar listat e kandidatëve për deputetë të subjekteve politike të certifikuara për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që mbahen më 7 qershor 2026.

Në kuptim të kësaj, analiza paraqet përfshirjen e personave të përfshirë në raste penale, në këto lista të kandidatëve për deputetë. Për qëllime të këtij raporti, me persona të përfshirë në raste penale nënkuptohen kandidatët të cilët kanë aktakuza aktive ose dënime penale të formës së prerë.

1. Përmbledhje ekzekutive

Më 7 qershor 2026, në Kosovë do të mbahen Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Për këtë proces zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar 21 subjekte politike dhe gjithsej 902 kandidatë për deputetë. Sikurse edhe në proceset e mëhershme zgjedhore, IKD bazuar në të dhënat e monitorimit të proceseve gjyqësore, në këtë raport ka paraqitur kandidatët për deputetë që janë të përfshirë në raste penale.

Sipas këtyre të dhënave, del se nga 902 kandidatët e certifikuar për deputetë, 25 prej tyre apo 2.77% janë persona të përfshirë në raste penale. Prej tyre, 15 kandidatë kanë aktakuza aktive, ndërsa 13 kandidatë kanë dënime penale të formës së prerë. Po ashtu, për tre (3) kandidatë është evidentuar se përveç dënimeve penale të mëhershme, kanë edhe aktakuza aktive. Ndërkaq, në raport mund të ketë edhe raste të rehabilitimit ligjor.

Sipas subjekteve politike, bazuar në të dhënat e monitorimit, rezulton se në raport me tërësinë e 902 kandidatëve të certifikuar për deputetë, LVV ka numrin dhe peshën më të madhe të kandidatëve të përfshirë në raste penale, me 13 kandidatë apo 1.44% të numrit të përgjithshëm të kandidatëve. Pas saj renditen AAK dhe LS me nga tre (3) kandidatë apo me nga 0.33% të totalit të kandidatëve. KDTP ka dy (2) kandidatë të përfshirë në raste penale, që përbëjnë 0.22% të totalit, ndërsa PSD, PDK, SDU dhe IRDK kanë nga një (1) kandidat, apo nga 0.11% të numrit të përgjithshëm prej 902 kandidatëve.

Në aspektin e veprave penale, sipas kapitujve të Kodit Penal, dominojnë veprat që ndërlidhen me korrupsionin, ndërkaq sipas veprave penale dominon "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm." Konkretisht, 10 kandidatë janë evidentuar për veprën penale "Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm", ndërsa shtatë (7) kandidatë për "Keqpërdorim të pozitës/detyrës apo autoritetit zyrtar".

Nëse krahasohen të dhënat e këtij raporti me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, atëherë del të jetë se është shënuar progres në raport me numrin e kandidatëve me aktakuza aktive, konkretisht me tre (3) kandidatë më pak, dhe numrin e kandidatëve të përfshirë në raste penale, me dy (2) kandidatë më pak. Derisa, regres është shënuar në raport me numrin e kandidatëve me dënime penale dhe numrin e subjekteve politike me kandidatë të përfshirë në raste penale, me nga 1 (një) më shumë sesa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025.

Ndërkaq, nëse krahasohen me zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, rezulton se është shënuar regres në pothuajse të gjitha pikat e vlerësimit.

2. Zgjedhjet e parakohshme 2026

Viti i kaluar u konsiderua si vit zgjedhor, pasi zgjedhjet e 28 dhjetorit shënuan procesin e tretë zgjedhor brenda atij viti, ku dy prej këtyre proceseve ishin procese zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në shkurt të këtij viti KQZ certifikoi rezultatet përfundimtare për zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit 2025.¹

Kësaj radhe Kuvendi arriti të votonte Qeverinë Kurti 3,² por jo edhe presidentin brenda afatit kushtetues,³ ndonëse për herë të parë që nga shpallja e pavarësisë partia e parë kishte marrë 51.10% të votave.⁴

Kështu, çështja e zgjidhjes së presidentit u bë shkaktar i shpërndarjes së Kuvendit, e rrjedhimisht zgjedhjeve të parakohshme që do mbahen më 7 qershor të këtij viti.

Për këtë proces zgjedhor u certifikuan 21 subjekte politike, tri (3) prej të cilave koalicione, 17 parti politike dhe një (1) kandidat i pavarur.⁵ Derisa, janë certifikuar gjithsej 902 kandidatë për deputetë.⁶

¹ "KQZ certifikoi rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e e Kosovës, 28 dhjetor 2025". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. 09 shkurt 2026. (Shih linkun: <https://kqz-ks.org/kqz-certifikoi-rezultatet-perfundimtare-te-zgjedhjeve-te-parakohshme-per-kuvendin-e-e-kosoves-28-dhjetor-2025/>, shikimi i fundit me 28 maj 2026).

² "Votohet Qeveria Kurti 3". Dukagjini. 11 Shkurt 2026. (Shih linkun: <https://www.dukagjini.com/votohet-qeveria-kurti-3/>, Shikimi i fundit me 28 maj 2026)

³ "S'ka President, shpërndahet Kuvendi i Kosovës". Lajmi. 29 Prill 2026. (Shih linkun: <https://lajmi.net/2nga-deshtimi-ne-deshtim-kuvendi-nuk-arrin-te-zgjedh-presidentin-vendi-drejt-zgjedhjeve-te-jashtezakonshme4/>, Shikimi i fundit 28 maj 2026).

⁴ "REZULTATET E PËRGJITHSHME SIPAS SUBJEKTEVE POLITIKE- UKUPNI REZULTATI PO POLITIČKIM SUBJEKTIMA". Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. (Shih linkun: https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2026/02/Perqindja_e_subjekteve_parlamentare-1-f-1.pdf, shikimi i fundit 28 maj 2026).

⁵ "KQZ certifikon për zgjedhje të parakohshme tri koalicione e një kandidat të pavarur, refuzohet certifikimi i dy subjekteve politike". Betimi për Drejtësi. 14 Maj 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kqz-certifikon-per-zgjedhje-te-parakohshme-tri-koalicione-e-nje-kandidat-te-pavarur-refuzohet-certifikimi-i-dy-subjekteve-politike/>, Shikimi i fundit 28 maj 2026).

⁶ "KQZ certifikon kandidatët e subjekteve politike". Betimi për Drejtësi. 16 Maj 2026. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kqz-certifikon-kandidatet-e-subjekteve-politike/>, shikimi i fundit 28 maj 2026).

3. Dekriminalizimi i politikës

Sikurse është theksuar edhe më herët, IKD në vazhdimësi ka avokuar për dekriminalizimin e politikës dhe forcimin e integritetit të përfaqësuesve publikë.

Në këtë kuptim, IKD konsideron se personat e përfshirë në raste penale nuk duhet të jenë pjesë e listave zgjedhore dhe as bartës të funksioneve të rëndësishme publike. Në kuptim të kësaj, për qëllime të këtij raporti, përfshirja në raste penale nënkupton rastet kur kandidatët kanë aktakuza aktive ose dënime penale të formës së prerë.

Për ta qartësuar, me këtë nuk nënkuptohet se këtyre personave ligjërisht u ndalohet që të jenë kandidatë për tu zgjedhur deputetë. Kjo për shkak se me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, është përcaktuar standardi ligjor për kufizimin e të drejtës për kandidim. Sipas këtij ligji, një person nuk mund të kandidojë për deputet nëse në tri (3) vitet e fundit është dënuar me vendim të formës së prerë me një (1) vit apo më shumë burgim efektiv.

Megjithatë, përtej këtij kufizimi ligjor, IKD vlerëson se subjektet politike duhet të aplikojnë standarde më të larta të integritetit gjatë hartimit të listave zgjedhore.

Në demokracitë funksionale, integriteti i personave që synojnë të marrin mandat publik trajtohet si element thelbësor i besimit qytetar në institucione. Për këtë arsye, subjektet politike kanë përgjegjësi që, përtej respektimit formal të ligjit, të kontribuojnë në ruajtjen e besimit publik duke shmangur kandidimin e personave të përfshirë në raste penale. Në të kundërtën, cenohet perceptimi publik për integritetin institucional dhe dëmton besimin në procesin demokratik.

Derisa duhet theksuar se IKD vlerëson se moskandidimi i personave të përfshirë në raste penale nuk nënkupton paragjykim të fajësisë së tyre dhe as cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi garantojnë se çdo person konsiderohet i pafajshëm deri në nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Mirëpo, standardi i integritetit publik kërkon që personat që synojnë të ushtrojnë funksione publike të jenë subjekt i një niveli më të lartë të përgjegjësisë politike dhe etike.

Për këtë arsye, IKD konsideron se partitë politike duhet të ndërtojnë mekanizma të brendshëm që garantojnë standarde më të larta të integritetit në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur kandidimi mund të jetë ligjërisht i lejuar, por përfshirja e kandidatëve në raste penale krijon pasoja negative për besimin publik dhe kredibilitetin e institucioneve përfaqësuese.

4. Pastërtia e listave për Zgjedhjet e Parakohshme 2026

Siç u përmend edhe më lartë, për këto zgjedhje të parakohshme janë certifikuar gjithsej 902 kandidatë për deputetë, që përfaqësojnë 21 subjekte politike. Pas procesit të certifikimit, IKD ka analizuar këto lista duke u bazuar në të dhënat e monitorimit të rasteve gjyqësore.

IKD ka gjetur se nga 902 kandidatë, 25 prej tyre janë të përfshirë në raste penale. Për qëllime të këtij raporti, me kandidatë që janë përfshirë në raste penale nënkuptohet kandidatët që kanë aktakuza aktive aktualisht, apo që kanë dënime penale në të kaluarën, mirëpo që ligjërisht nuk iu kufizohet e drejta për të kandiduar si deputet. Rrjedhimisht, i bie se 2.77% e kandidatëve janë të përfshirë në raste penale.

Ndërkaq, janë evidentuar tre (3) kandidatë për deputetë të cilët kanë pasur dënime penale si dhe kanë aktakuzë aktive.

5. Kandidatët me aktakuza aktive

Sipas të dhënave të analizuara nga monitorimi, IKD ka arritur të gjej se 15 kandidatë për deputetë kanë aktakuza aktive për vepra të ndryshme penale.

Në vijim, në formë tabelare janë paraqitur se cilët janë këta kandidatë dhe për çfarë veprash penale janë duke u akuzuar.

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Subjekti politik	Numri i rasteve	Vepra penale	Viti aktakuzës
1	Agim Çeku	AAK	1	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	2019
2	Arbërie Nagavci	LVV	1	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	2019
3	Branislav Nikoliq	LS	1	1. Marrja e rryshfetit 2. Keqpërdorimi i detyrës 3. Ushtrimi i ndikimit	2021
4	Dardan Molliqaj	PSD	1	Sulmi	2020
5	Egzon Azemi	LVV	1	Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit	2023

6	Fikrim Damka	KDTP	2	1. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar 2. Sulmi & Kanosja	1. 2025 2. 2025
7	Fitore Pacolli-Dalipi	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019
8	Glauk Konjufca	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2017
9	Rozeta Hajdari	LVV	1	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	2025
10	Salih Zyba	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019
11	Shkumbin Demaliaj	PDK	1	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	2019
12	Slavko Simiq	LS	1	Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi	2025
13	Sreten Ivanoviq	LS	1	Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar	2023
14	Valon Ramadani	LVV	1	1. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm 2. Pengim i personit zyrtar, në kryerjen e detyrës zyrtare	2019
15	Xhelal Sveçla	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2019

Tabela 1. Kandidatët me aktakuza aktive.

6. Kandidatët me dënime penale

IKD po ashtu ka arritur të identifikojë 13 kandidatë të cilët në të kaluarën kanë pasur dënime të formës së prerë.

Më poshtë janë paraqitur në formë tabelare se cilët janë këta kandidatë, dënimet që janë shqiptuar ndaj tyre, si dhe veprat penale për kryerjen e të cilave janë dënuar.

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Subjekti	Numri i rasteve	Vepra Penale	Viti i dënimit	dënimi
1	Albin Kurti	LVV	1	1. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm 2. Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare	2018	Dënimi unik: 1 vjet e 6 muaj burgim me kusht
2	Albulena Haxhiu	LVV	1	1. Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm 2. Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare	2018	Dënimi unik: 1 vjet e 6 muaj burgim me kusht
3	Bajram Mavriqi	LVV	1	Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiar	2020	1500 euro dënim me gjobë
4	Dardan Molliqaj	PSD	1	Sulm ndaj personit zyrtar	2025	6 muaj burg i kthyer në 2 mijë euro dënim me gjobë
5	Enver Hoti	AAK	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2022	1 vit burgim me kusht
6	Liza Gashi	LVV	1	Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë	2023	500 euro dënim me gjobë


				tjetër materiale ose i detyrimeve financiare		
7	Mytahir Haskuka	LVV	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2016	1 vjet burgim me kusht
8	Rifat Krasniç	KDTP	1	Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar	2023	1 mijë e 700 euro dënim me gjobë
9	Rozeta Hajdari	LVV	1	Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	2022	700 euro dënim me gjobe
10	Samra Ilijazi	SDU	1	Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiar	2022	200 euro dënim me gjobë
11	Sreten Ivanoviq	LS	1	Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiar	2023	300 euro dënim me gjobë
12	Tefik Nura	IRDK	1	Vjedhje	2014	3 muaj burg i kthyer në 150 orë pune
13	Teuta Haxhiu	AAK	1	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	2022	1 vit burgim me kusht

Tabela 2. Kandidatët me dënime të formës së prerë.

7. Kandidatët e përfshirë në raste penale sipas subjekteve


Sipas të dhënave të monitorimit, IKD ka gjetur se nga 21 subjektet politike të certifikuara për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin, 8 subjekte kanë kandidatë të përfshirë në raste penale. Megjithatë, subjektet kanë pjesëmarrje të ndryshme të përfshirjes së kandidatëve që kanë probleme me ligjin në listat zgjedhore.

Bazuar në këto të dhëna, rezulton se në raport me tërësinë e 902 kandidatëve të certifikuar për deputetë, LVV ka numrin dhe peshën më të madhe të kandidatëve të përfshirë në raste penale, me 13 kandidatë apo 1.44% të numrit të përgjithshëm të kandidatëve. Pas saj renditen AAK dhe LS me nga tre (3) kandidatë apo me nga 0.33% të totalit të kandidatëve. KDTP ka dy (2) kandidatë të përfshirë në raste penale, që përbëjnë nga 0.22% të totalit, ndërsa PSD, PDK, SDU dhe IRDK kanë nga një (1) kandidat, apo nga 0.11% të numrit të përgjithshëm prej 902 kandidatëve.




Grafiku 1. Pësia e kandidatëve të përfshirë në raste penale sipas subjekteve politike, në raport me numrin total të kandidatëve.

Për nga numri i kandidatëve të përfshirë në raste penale, del se LVV ka numrin më të lartë të tyre në krahasim me subjektet tjera.



Grafiku 2. Numri i kandidatëve të përfshirë në raste penale sipas subjekteve.

Pra, në këto zgjedhje numri total i kandidatëve që janë të përfshirë në raste penale është 25. Numri më i lartë i tyre vijnë nga radhët e LVV-së, të cilët përbëjnë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të kandidatëve të përfshirë në raste penale, apo 52.00%. Kurse, pjesën tjetër e përfshijnë shtatë (7) subjektet e tjera.



Grafiku 3. Cilit subjekt i përkasin kandidatët e përfshirë në raste penale?

8. Kandidatët e përfshirë në raste penale sipas veprave

IKD ka analizuar veprat penale në të cilat janë përfshirë kandidatët për deputetë të subjekteve politike. Sipas të dhënave nga monitorimi, del të jetë se 25 kandidatët e përfshirë në raste penale ndërlidhen me një numër të konsiderueshëm veprash penale të natyrave të ndryshme.

Këta 25 kandidatë, përfshihen në gjithsej 29 raste penale. Derisa në disa raste, sipas tabelave më lart (*tabelat 1 dhe 2*) ka kandidatë që akuzohet për më shumë se një vepër penale në një rast të vetëm.

Sipas kapitujve, veprat penale më të shpeshta dalin të jenë ato që hyjnë në kapitullin e korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare, 14 herë. Koncretisht, "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar" është vepra penale për të cilën janë përfshirë shtatë (7) kandidatë, kurse pesë (5) kandidatë janë të përfshirë për veprën penale "Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dhuratave apo detyrimeve financiare". Ndërkaq, për veprën

penale “Marrja e ryshfetit” dhe “Ushtrimi i ndikimit” janë përfshirë nga një kandidat.

Ndërsa, si vepra penale më e shpeshtë del të jetë “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, 10 herë.

Po ashtu, kandidatët janë evidentuar edhe për vepra tjera penale, si: pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi, marrja e ryshfetit, ushtrimi i ndikimit, si dhe vepra tjera të natyrave të ndryshme penale.

Tabela në vijim paraqet veprat penale dhe numrin e kandidatëve të përfshirë në secilën prej tyre.

Vepra penale	Nr. i kandidatëve
<i>Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm</i>	10
<i>Keqpërdorimi i pozitës/detyrës apo autoritetit zyrtar</i>	7
<i>Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë/të ardhurave/dhuratave/detyrimeve financiare</i>	5
<i>Pengimi i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare</i>	3
<i>Sulmi</i>	2
<i>Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve</i>	1
<i>Nxitja e përçarjes dhe mosdurimit</i>	1
<i>Kanosja</i>	1
<i>Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi</i>	1
<i>Marrja e ryshfetit</i>	1
<i>Ushtrimi i ndikimit</i>	1
<i>Sulm ndaj personit zyrtar</i>	1
<i>Vjedhje</i>	1

Tabela 3. Veprat penale dhe numri i kandidatëve të përfshirë.

9. Krahasimi me zgjedhjet paraprake

IKD ka publikuar vazhdimisht analiza të tilla edhe në proceset zgjedhore të viteve paraprake.⁷ Me qëllim të evidentimit të trendit të përfshirjes së kandidatëve në raste penale nga ana e subjekteve politike, edhe në këtë raport paraqitet një krahasim me të dhënat e zgjedhjeve të mëhershme parlamentare.

Për Zgjedhjet e parakohshme të vitit 2021, IKD kishte evidentuar 33 kandidatë të përfshirë në raste penale, të cilët ishin pjesë e listave të 6 subjekteve politike. Ndërkaq, për Zgjedhjet Parlamentare të 9 shkurtit 2025, numri i kandidatëve të përfshirë në raste penale kishte rënë në 23 kandidatë, të shpërndarë në vetëm 3 subjekte politike.

Në raport me zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit 2025, kur ishin evidentuar 27 kandidatë të përfshirë në raste penale, nga të dhënat e monitorimit rezulton se për zgjedhjet e vitit 2026 ka një ulje të lehtë të këtij numri. Konkretisht, IKD ka evidentuar 25 kandidatë të përfshirë në raste penale.

Megjithatë, pavarësisht uljes së numrit të përgjithshëm të kandidatëve të përfshirë në raste penale në krahasim me zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, është rritur numri i subjekteve politike që në listat e tyre kanë përfshirë kandidatë të tillë. Derisa në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2025 kandidatë të përfshirë në raste penale ishin evidentuar në listat e 7 subjekteve politike, në zgjedhjet e parakohshme të vitit 2026, kandidatë të tillë janë evidentuar në listat e 8 subjekteve politike. Krahasimi me zgjedhjet paraprake, në vijim është paraqitur edhe në formë tabelare.

⁷ Zgjedhjet e parakohshme 2021: Integriteti i listës zgjedhore të Nismës Socialdemokrate, Instituti i Kosovës për

Drejtësi (IKD), (Shih linkun: <https://kli-ks.org/zgjedhjet-e-parakohshme-2021-integriteti-i-listes-zgjedhore-te-nismes-socialdemokrate/>); Zgjedhjet e parakohshme 2021: Integriteti i listës zgjedhore të Listës Serbe, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD / KLI-KS), Shih linkun: <https://kli-ks.org/zgjedhjet-e-parakohshme-2021-integriteti-i-listes-zgjedhore-te-listes-serbe/>); Zgjedhjet e parakohshme 2021: Integriteti i listës zgjedhore të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), (Shih linkun: <https://kli-ks.org/zgjedhjet-e-parakohshme-2021-integriteti-i-listes-zgjedhore-te-aleances-per-ardhmerine-e-kosoves/>); Integriteti i listës zgjedhore të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), (Shih linkun: <https://kli-ks.org/zgjedhjet-e-parakohshme-2021-integriteti-i-listes-zgjedhore-te-lidhjes-demokratike-te-kosoves/>); Zgjedhjet e parakohshme 2021: Integriteti i listës zgjedhore të Partisë Demokratike të Kosovës, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), (Shih linkun: <https://kli-ks.org/zgjedhjet-e-parakohshme-2021-integriteti-i-listes-zgjedhore-tepartise-demokratike-te-kosoves/>); Zgjedhjet e parakohshme 2021: Integriteti i listës zgjedhore të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), (Shih linkun: <https://kli-ks.org/zgjedhjet-e-parakohshme-2021-integriteti-i-listes-zgjedhore-te-levizjes-vetevendosje/>).

Koalicioni i organizatave (FOL, IKD dhe INPO) "Integriteti i kandidatëve, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë

(Zgjedhjet Parlamentare 2025: Analizë e listave të kandidatëve dhe programeve politike" Prishtinë, 2025.(Shih linkun: <https://kli-ks.org/integriteti-i-kandidateve-sundimi-i-ligjit-dhe-qeverisja-e-mire/>).

Pika e vlerësimit	Zgjedhjet e 2021	Zgjedhjet e 9 shkurtit 2025	Zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025	Zgjedhjet 2026
<i>Nr. i kandidatëve të përfshirë në raste penale</i>	33	23	27	25
<i>Nr. i kandidatëve me aktakuza aktive</i>	29	16	18	15
<i>Numri i kandidatëve me dënime penale</i>	5	8	12	13
<i>Numri i subjekteve politike me kandidatë të përfshirë në raste penale</i>	6	3	7	8

Tabela 4. Trendi i përfshirjes së kandidatëve të përfshirë në raste penale.

